

Sandra Kuka u lind në Shkodër me 12 dhjetor 1985. Ajo është diplomuar si arkitekte në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Tiranës.

Aktualisht zj. Kuka punon si specialiste arkitekte në Sektorin e Studimeve dhe Koordinimit të Investimeve Bashkiake në Drejtorinë e Studimit, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve pranë Bashkisë Shkodër.

Më herët, ajo ka punuar si specialiste arkitekte në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Shkodër dhe si specialiste inxhinierë në Zyrën e AKKP Shkodër.

Zj. Kuka është njohëse e dy gjuhëve të huaja dhe e programeve kompjuterike profesionale.